

BASHKIA E TIRANËS
AGJENCIA E PARQEVË DHE REKREACIONIT

Data 09.07.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

BLERJE MAKINERI PËR PASTRIMIN E BASENEVE

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Automjetet për mbledhjen e mbeturinave -34144511-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 18,300,000 (Tetëmbëdhjetë milion e treqind mijë) Lekë pa Tvsh.

Vlera e fondit Limit në monedhën ndërkombëtare Euro sipas kursit të Bankës së Shqipërisë është 196,015.42 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e pesëmbëdhjetë pikë dyzetë e dy) euro.

Kursi zyrtar i këmbimit për monedhën euro sipas Bankës të Shqipërisë datë 03.08.2026 është 93.36 euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “**Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Arsyetimi ligjor për mosndarjen në lote të procedurës së prokurimit

Bazuar në nenin 39 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", autoriteti kontraktor ka detyrimin që, gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit dhe planifikimit të prokurimit, të shqyrtojë mundësinë e ndarjes së procedurës në lote, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe rritjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

Në rastin konkret, objekti i prokurimit është "**Blerje makineri për pastrimin e baseneve**". Pas një vlerësimi teknik dhe ekonomik, Autoriteti Kontraktor ka vendosur të mos e ndajë procedurën në lote, pasi objekti i prokurimit konsiston në furnizimin me një kategori të vetme makinerish, të cilat përbëjnë një tërësi funksionale dhe nuk përmbajnë grupe të ndryshme mallrash që mund të prokurohen në mënyrë të pavarur.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se zhvillimi i procedurës në një kontratë të vetme është zgjidhja më e përshtatshme.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: "...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik..."

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; përkatesisht në vlerën: 366 000 (treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit të Bankes së Shqipërisë është 3,920.3 (tre mijë e nentëqind e njëzetë pike tre) euro.*

Kursi zyrtar i këmbimit për monedhën euro sipas Bankës të Shqipërisë datë 03.08.2026 është 93.36 euro.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, i ndryshuar si dhe nenin 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: "...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël..."

"...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe..."

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: (nëse është e aplikueshme)

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/b dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar në të cilin përcaktohet se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë vlerën e vlerës së përllogaritur të lotit.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur mbi kufirin e lartë monetar– Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare", dhe Kreu II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, të VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në vitin 2026 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2026 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2025 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2023, 2024 dhe 2025.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor ku të përfshihen **këstet e maturuara të vitit 2026** sipas përcaktimeve të Ligjit nr Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe adresat sekondare.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore , do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor ku të përfshihen **këstet e maturuara të vitit 2026** sipas përcaktimeve të Ligjit nr Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të operatorëve ekonomikë të suksesshëm dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika

c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2025 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3.Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më e vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a: për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ose,

b: për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të LPP, si dhe pikës 4 të nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet ndër të tjera se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.*

“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara”.

2.3.2 Në rast se Operatori Ekonomik nuk është vetë prodhues, duhet të paraqesë **Autorizim nga prodhuesi** ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuara. Në rast se do të paraqitet kjo e fundit, duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 pika 8, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokumenti rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet një kohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushjen me sukses të kontratës

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **certifikatat e prodhuesit** për të vërtetuar se produkti është konform standardeve të kërkuara në specififikimet teknike:

2.3.3/a Makineria e ofertuar duhet të jetë e projektuar dhe e prodhuar në përputhje me standardin **SSH EN ISO 12100:2010 (e perditesuar)** ose ekuivalent, që përcakton terminologjinë bazë, parimet dhe

metodologjinë për arritjen e sigurisë në projektimin e makinerive, si dhe parimet e vlerësimit dhe reduktimit të rrezikut.

2.3.3/b Makineria e ofertuar duhet të jetë në përputhje me standardin **SSH EN 60204-1:2018 (e perditesuar)** ose

ekuivalent, që përcakton kërkesat e sigurisë për pajisjet elektrike, elektronike dhe elektronike të programueshme të makinerive

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën përkatëse ose dokument ekuivalent të lëshuar nga prodhuesi ose nga një organ i akredituar i vlerësimit të konformitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenin 41 pika 6 ku citohet: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë dhe mbajnë përgjegjësi për kryerjen e shërbimit për përmbushje me suksese të kontratës objekt prokurimi.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), si dhe në VKM nr 759, datë 12.11.2014 “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” (i ndryshuar).

Makineria objekt prokurimi do të përdoret në kushte pune ku siguria e operatorëve, besueshmëria në funksionim dhe mbrojtja e pajisjes përbëjnë elementë thelbësorë për realizimin e objektit të kontratës. Për këtë arsye, është e nevojshme që pajisja e ofertuar të jetë projektuar dhe prodhuar në përputhje me standarde ndërkombëtare të njohura, të cilat garantojnë përmbushjen e kërkesave minimale të sigurisë dhe cilësisë. Standardi SSH EN ISO 12100:2010

siguron që projektimi i makinerisë është realizuar mbi bazën e një procesi sistematik të identifikimit, vlerësimit dhe reduktimit të rreziqeve mekanike, elektrike, hidraulike, ergonomike dhe të tjera që lidhen me përdorimin e saj gjatë gjithë ciklit të jetës. Përputhshmëria me këtë standard minimizon rrezikun e aksidenteve, rrit sigurinë e përdoruesve dhe garanton që makineria është projektuar sipas praktikave më të mira ndërkombëtare. Po kështu, standardi SSH EN 60204-1:2018 garanton që sistemi elektrik i makinerisë është projektuar dhe realizuar në përputhje me kërkesat ndërkombëtare të sigurisë elektrike, duke siguruar mbrojtje ndaj goditjeve elektrike, defekteve të qarkut, rreziqeve nga zjarri dhe keqfunksionimeve të sistemit të komandimit. Përmbushja e këtij standardi është veçanërisht e rëndësishme për makineritë që funksionojnë në mënyrë të vazhdueshme ose në kushte pune intensive.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e objektit të kontratës, duhet të disponojë si më poshtë:

- a) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër **kryerjen e riparimeve në rast avarie** dhe të shërbimeve periodike të mirëmbajtjes së pajisjes objekt kontrate, gjatë kohëzgjatjes së garancisë.
- b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër, **të trajnojë 1 (një) punonjës të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit (APR) për përdorimin dhe operimin e pajisjes objekt kontrate.**

Argumentimi: Në bazë të pikës 1, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

Pajisja objekt prokurimi është një pajisje e specializuar, e cila për shkak të karakteristikave teknike, teknologjisë së përdorur dhe funksioneve që kryen, kërkon personel me kualifikim dhe trajnim specifik për vënien në punë, mirëmbajtjen, riparimin dhe përdorimin e saj. Funksionimi i saktë i pajisjes ndikon drejtpërdrejt në realizimin e objektivave të autoritetit kontraktor, si dhe në garantimin e sigurisë gjatë përdorimit të saj. Gjithashtu është e nevojshme që operatori ekonomik të disponojë të paktën një punonjës të trajnuar dhe/ose të certifikuar për përdorimin dhe operimin e pajisjes. Ky person do të garantojë përdorimin korrekt të pajisjes gjatë dorëzimit, kryerjen e testeve funksionale, demonstrimin praktik të funksionimit të saj, si dhe ofrimin e trajnimit dhe asistencës teknike për personelin e autoritetit kontraktor, duke siguruar që pajisja të përdoret në përputhje me manualët, udhëzimet dhe standardet teknike të prodhuesit.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës të garantojë që në momentin e dorëzimit pajisja do të shoqërohet me certifikate garancie me vlefshmëri të paktën 1 (një) vit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët

ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t'u garantuar se mallrat objekt prokurimi do të përmbushin kërkesat teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat (defektet) që mund të lindin, jo për shkak të Autoritetit. Çdo prodhues ose distributor shitës ofron garanci për automjetet e reja për një afat të caktuar.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

- Trupi i makinerisë duhet të jetë metal hekuror (material rezistent kundër ndryshkut), me dimensione minimale prej 8 metra gjatësi, minimalisht 3 metra gjerësi dhe minimalisht 1 metër lartësi

Argumentimi:

Gjatësia minimale prej 8 metrash për trupin e makinerisë është përcaktuar në funksion të nevojës për të akomoduar në mënyrë të integruar dhe funksionale të gjitha nënsistemet kryesore të pajisjes, si dhe për të garantuar qëndrueshmëri dhe stabilitet gjatë operimit mbi sipërfaqen ujore.

- Duhet të jetë e pajisur me një sistem për prerjen e barërave, i cili përfshin prerëse horizontale, vertikale dhe një prerëse rrethore, e cila mundëson funksionim efektiv në kushte të veçanta dhe për aplikime të ndryshme.

- Makinaria duhet të jetë e aftë të presë barërat, algat, kallamishtet etj., minimalisht deri në 1 metër nën nivelin e ujit dhe gjerësia e prerjes me një kalim të jetë minimalisht 2 metra, për të siguruar rendiment sa më të lartë në punë dhe konsum optimal kohe dhe karburanti.

Argumentimi:

Thellësia prerëse prej të paktën 1 metër nën nivelin e ujit është e nevojshme pasi leshteriku dhe bimësia tjetër ujore zhvillon rrënjë dhe vegjetacion që shtrihet nën sipërfaqe; një prerje vetëm sipërfaqësore do të linte pjesën e poshtme të bimësisë të pacenuar, duke shkaktuar rigjenerim të shpejtë dhe duke e bërë ndërhyrjen joefektive afatgjatë.

Gjerësia prerëse prej minimalisht 2 metra me një kalim rrit sipërfaqen e pastruar për njësi kohe, duke ulur numrin e kalimeve të nevojshme për të mbuluar të njëjtën zonë. Kjo përkthehet direkt në më pak orë pune, konsum më të ulët karburanti dhe efikasitet më të lartë operacional, veçanërisht duke pasur parasysh sipërfaqen e gjerë ujore që administrohet nga APR.

- Të jetë e pajisur me zinxhirë transportues çeliku të cilët do të mundësojnë transportimin e materialeve të prerë nga prerësit deri në depozitën e mbetjeve. Zinxhiri duhet të jetë minimalisht 5 metër i gjatë dhe minimumi 1 metër i gjerë për të siguruar qëndrueshmërinë

dhe efikasitetin në transportin e mbetjeve si dhe për ta garantuar rendimentin e kërkuar të pastrimit dhe korrjes.

- Depozita e mbetjeve të ketë një kapacitet mbajtës prej jo më pak se 13 m³.

Argumentim:

Ky parametër del si pasojë e llogaritjes duke u bazuar në parametrat që kemi kërkuar me sipër për makinerisë teknologjike në funksion të garantimit të një rendimenti optimal pune.

- Makinaria duhet të jetë e pajisur me një kabinë për mbrojtjen e operatorit nga kushtet atmosferike dhe për të mundësuar kryerjen e të gjitha funksioneve kontrolluese të varkës. Për të garantuar kushte komode pune për drejtuesin e mjetit, të jetë e pajisur me sedilje rrotulluese për të mundësuar manovrim sa më të lehtë të mjetit në të gjithë drejtimet.
- Trupi i varkës duhet të jetë i lyer me bojë kompozite për mbrojtje kundër gërryerjes dhe i mbrojtur me anodë për të siguruar një mbrojtje të shkëlqyer ndaj korrozionit dhe dëmtimeve të mundshme nga kontakti me ujin dhe mjedisin e jashtëm.
- Makinaria duhet të jetë prodhim i ri (e papërdorur).
- Duhet të arrijë një shpejtësi të paktën prej 6 km/h në kushte normale dhe jo më pak se 2 km/h në kushte pune. Të lëvizë me anë të lopatave automatike për të parandaluar bllokimin nga barërat ose mbetjet e tjera. Lopatat duhet të mundësojnë lëvizje përpara dhe mbrapa, si dhe të ofrojnë mundësinë e rrotullimit të pavarur nga njëra-tjetra, si dhe rrotullim në drejtime të kundërta, për të kthyer varkën në vend.
- Ajo duhet të jetë e pajisur me një motorr me karburant dhe me një fuqi minimale prej 90 KW. Furnizimi me karburant të bëhet në breg.

Argumentimi :

Fuqia minimale prej 90 KW është e nevojshme për të siguruar energji të mjaftueshme që motori të drejtojë njëkohësisht të gjitha funksionet e makinerisë — sistemin e trefishtë prerës, zinxhirin transportues, sistemin hidraulik dhe lëvizjen e vetë mjetit mbi ujë — pa rënie performance apo mbingarkesë, veçanërisht gjatë punës në kushte të vështira (vegjetacion i dendur, rezistencë e lartë e ujit, sipërfaqja e madhe ujore rreth 5 hektar).

- Për arsye sigurie, të jetë e pajisur me sistem sinjalizimi gjatë lëvizjes në drejtim të kundërt, për të shmangur kontaktin me objekte të tjera lundruese.
- Të mundësojë montimin e flamurit, për ta identifikuar si mjet pune të institucionit publik gjatë procesit të pastrimit dhe lundrimit në liqen.

Specifikimet teknike

Emërtimi	Njësia Matëse	Vlera
Gjatësia	Metra	Jo më e vogël se 8m
Gjerësi	Metra	Jo më e vogël se 3m
Lartësi	Metra	Jo më e vogël se 1m
Lartësia e prerjes	Metra	Jo më e vogël se 1m
Gjerësia e prerjes	Metra	Jo më e vogël se 2m
Depozita e Mbetjeve	M ³	Jo me e vogël se 13 m ³
Fuqia e motorrit	KW	Jo me e vogël se 90 KW

Shpejtësia në kushte normal	KM/h	Jo me e vogël se 6 KM/h
Shpejtësia në kushte punë	KM/h	Jo me e vogël se 2 KM/h

Argumentim

Makineria për pastrimin e baseneve është projektuar me dimensione dhe material që garanton stabilitet, qëndrueshmëri dhe efikasitet maksimal gjatë operimit në kushte të vështira ujore. Makineria prej çeliku, me trupin e lyer me bojë kompozite dhe mbrojtur me anodë, siguron një mbrojtje të shkëlqyer ndaj korrozionit. Sistemi i trefishtë prerës i kombinuar me aftësinë për të punuar deri në 1 metër nën ujë dhe gjerësi prerëse prej 2 m, siguron eliminimin efektiv të vegjetacionit duke parandaluar rigjenerimin e shpejtë të tij. Zinxhiri transportues dhe depozita me kapacitet minimalisht 13 m³ me zbrazje automatike rrisin produktivitetin duke minimizuar ndalesat operacionale, ndërsa motori me karburant me fuqi minimalisht 90 kw dhe sistemi hidraulik i avancuar garantojnë fuqi të mjaftueshme për të drejtuar njëkohësisht të gjithë funksionet e makinerisë. Për të garantuar kushte komode pune për drejtuesin e mjetit, të jetë e pajisur me sedilje rrotulluese për të mundësuar manovrim sa më të lehtë të mjetit në të gjithë drejtimet.

Kohëzgjatja e kontratës: Data e fillimit dhe periudha e dorëzimit të mallit: 60 ditë pune nga data e nënshkrimit të kontratës.